



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 447, datë 24.07.2023

MBI

NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT DHE TRANSFERIMIN E FONDEVE NË PROGRAMIN 03310, SHPENZIME KAPITALE, PËR VITIN BUXHETOR 2023

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitin 2023”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të destinacionit të fondeve buxhetore të miratuara për realizimin e Projektit të sigurisë së gjykatave, me destinacion realizimin e Projektit për regjistrimin video të sallave të gjyqit (RDAV), në gjykatat, në shumën 173,100,000 lekë.
2. Miratimin e rishpërndarjes (transferimin) së fondeve në programin 03310, shpenzime kapitale, duke pakësuar fondet në kodin e projektit 18AD801 (blerje pajisje zyre), në shumën 173,100,000 lekë dhe shtuar fondet në kodin e projektit 21AC401 (blerje pajisje elektronike), në shumën 173,100,000 lekë.
3. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR